

PROBABILITET DHE STATISTIKË(pjesa e parë)

Pyetja 1

Me shifrat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, pa i përsëritur ato, formohen numra 4 shifrorë. Sa numra formohen:

- A) $9 \cdot 8 \cdot 7 \cdot 6$
- B) $8 \cdot 8 \cdot 7 \cdot 6$
- C) $9 \cdot 9 \cdot 9 \cdot 9$
- D) $9 \cdot 8 \cdot 7 \cdot 6 \cdot 5$

Pyetja 2

Mesorja e shpërndarjes 7; 6,5; 9; 7,5; 8 është:

- A) 7,75
- B) 6,5
- C) 9
- D) 7,25

Pyetja 3

Sa numra shtatëshifrorë formohen me shifrat 2, 5:

- A) $7!$
- B) 7^2
- C) 2^7
- D) anjë prej tyre

Pyetja 4

Hidhen dy zare kubikë dhe lexohen shifrat në faqen e sipërme. Probabiliteti që të dy të bien 6 është:

- A) $\frac{1}{36}$
- B) $\frac{1}{6}$
- C) 2
- D) 6

Pyetja 5

Hidhen n zare kubikë dhe lexohen shifrat në faqen e sipërme. Probabiliteti që të gjithë të bien 6 është:

A) $\frac{1}{6^n}$

B) $\frac{1}{6}$

C) 1

D) 6^n

Pyetja 6

Gjatë 14 viteve të fundit, sasia vjetore e rreshjeve në një qytet në mm jepet më poshtë:

615 640 840 970 690 810 890
870 890 695 661 740 1120 1075

Moda e këtyre të dhënave është:

A) 615

B) 822

C) 890

D) 1120

Pyetja 7

Gjatë 14 viteve të fundit, sasia vjetore e rreshjeve në një qytet në mm jepet më poshtë:

615 640 840 970 690 810 890
870 890 695 661 740 1120 1075

Amplituda e këtyre të dhënave është:

A) 615

B) 605

C) 505

D) 409

Pyetja 8

Sa fjalë me 10 shkronja, me dhe pa kuptim, formohen nga shkronjat e fjalës MATEMATIKA:

A) $\frac{10!}{2! \cdot 3!}$

B) $\frac{10!}{2! \cdot 3! \cdot 2!}$

C) $10!$

D) asnjë prej tyre

Pyetja 9

Një klasë ka 34 studentë. Numri i përfaqësuesve prej 3 studentësh është:

A) 5000

B) C_{34}^3

C) C_{34}^{31}

D) 6854

Pyetja 10

Sa numra katërshifror që fillojnë me 5 formohen:

A) 1000

B) $10 \cdot 9 \cdot 8 \cdot 7$

C) 10 000

D) $10 \cdot 10 \cdot 10 \cdot 10$

Pyetja 11

Në sa mënyra të ndryshme mund të vendosen 7 libra në një raft biblioteke.

A) 40

B) 2050

C) 4050

D) 5040

Pyetja 12

Sa numra me 5 shifra formohen me numrat nga 0 deri në 9:

A) $9 \cdot 9 \cdot 8 \cdot 7 \cdot 6$

B) $10 \cdot 9 \cdot 8 \cdot 7 \cdot 6$

C) 9^5

D) 10^5

Pyetja 13

Një zar loje hidht dy herë. Probabiliteti që të bjerë i njëjti numër është:

A) $\frac{1}{6}$

B) $\frac{2}{6}$

C) $\frac{5}{6}$

D) $\frac{7}{6}$

Pyetja 14

Në një kuti janë vendosur 12 topa të bardhë, 8 jeshilë, 15 të kuq dhe 25 të ngjyrave të tjera. Nxirret një top nga kutia. Probabiliteti që ky top të mos jetë as i bardhë, as jeshil, është:

A) $\frac{1}{3}$

B) $\frac{2}{3}$

C) $\frac{1}{4}$

D) $\frac{5}{4}$

Pyetja 15

Rezultatet e një studimi për gjatësinë e fëmijëve janë:

155 170 166 160 174 186 185 168 180 170

Mesorja e të dhënave është:

- A) 160
- B) 170
- C) 174
- D) 180

Pyetja 16

Rezultatet e një studimi për gjatësinë e fëmijëve janë:

155 170 166 160 174 186 185 168 180 170

Mesatarja e të dhënave është:

- A) 160
- B) 165
- C) 170,4
- D) 180

Pyetja 17

Rezultatet e një studimi për gjatësinë e fëmijëve janë:

155 170 166 160 174 186 185 168 180 170

Moda e të dhënave është:

- A) 155
- B) 160
- C) 166
- D) 170

Pyetja 18

Rezultatet e një studimi për gjatësinë e fëmijëve janë:

155 170 166 160 174 186 185 168 180 170

Rangu i të dhënave është:

- A) 21
- B) 31
- C) 41
- D) 51

Pyetja 19

Në sa mënyra të ndryshme mund ti përgjigjemi me “po” ose “jo” një pyetësori me 10 pyetje:

- A) 10^2
- B) 2^{10}
- C) 1000
- D) 512

Pyetja 20

Në qoftë se elementet e bashkësisë E, n_1 janë të llojit të parë, n_2 janë të llojit të dytë, ... dhe n_k të llojit të k-të dhe $n_1 + n_2 + \dots + n_k = n$, atëherë numri i përkëmbimeve të ndryshme të E-së është:

- A) $\frac{n!}{n_k!}$
- B) $\frac{n!}{n_1! + n_2! + \dots + n_k!}$
- C) $\frac{n!}{n_1 n_2 \dots n_k}$
- D) $\frac{n!}{n_1! n_2! \dots n_k!}$

Pyetja 21

Në qoftë se A dhe B janë ngjarje të tilla që $P(B) > 0$, atëherë probabiliteti me kusht i A-së kur ka ndodhur B është:

- A) $\frac{P(A \cap B)}{P(B)}$
- B) $\frac{P(A \cap B)}{P(A)}$
- C) $\frac{P(A \cap B)}{P(A) \cdot P(B)}$
- D) asnjë prej tyre

Pyetja 22

Sipas shpërndarjes së Bernulit, nëse $P(X = 1) = p$ dhe $P(X = 0) = q$, ku $p + q = 1$, atëherë pritja matematike është:

- A) $E(X) = p$
- B) $E(X) = q$
- C) $E(X) = 1$
- D) asnjë prej tyre

Pyetja 23

Nëse X është një ndryshore rasti e tillë që X^2 ka pritje matematike, atëherë dispersioni i X është madhësia:

- A) $D(X) = E[X - E(X)]^2$
- B) $D(X) = E(X) - E(X)^2$
- C) $D(X) = E(X)^2 - E(X)^2$
- D) asnjë prej tyre

Pyetja 24

Në sa pika priten 12 drejtëza, në qoftë se 5 prej tyre janë paralele dhe nëpër çdo pikëprerje kalojnë 2 drejtëza:

- E) C_{12}^2
- F) C_{12}^3

G) $5 \cdot C_7^2$

H) $5 \cdot C_8^2$

Pyetja 25

Në tri klasa me 40, 35 dhe 30 nxënës, notat mesatare janë përkatësisht 6, 7 dhe 8. Nota mesatare e të tri klasave është:

A) 6,8

B) 6,9

C) 7

D) 7,1

Pyetja 26

Gjatë 12 viteve të fundit, sasia vjetore e rreshjeve në një qytet në mm jepet si më poshtë:

615 640 840 970 690 870 890 695 661 740 1120 1075

Mesorja e këtyre të dhënave është:

E) 1120

F) 1160

G) 1200

H) 1260

Pyetja 27

Gjatë 10 viteve të fundit, sasia vjetore e rreshjeve në një qytet në mm jepet si më poshtë:

615 640 840 970 690 870 890 695 660 740

Mesatarja e këtyre të dhënave është:

A) 615

B) 690

C) 712

D) 761

Pyetja 28

Rezultatet e kontrollit të kohës së punës në orë që duhen për kontrollin e cilësisë së pajisjeve elektronike jepet nga tabela.

Koha e punës (orë)	Numri i pajisjeve
[300; 400)	15
[400; 500)	46
[500; 600)	60
[600; 700)	54

Mesatarja e kësaj shpërndarje statistikore është:

- A) $\approx 537,5$
- B) $\approx 420,5$
- C) ≈ 550
- D) ≈ 650

Pyetja 29

Rezultatet e një provimi në një grup studentësh, jepen në tabelë:

Nota	3	4	5	6	7	8	9	10
Efektivi	1	3	6	12	8	2	5	3

Mesatarja e kësaj shpërndarje statistikore është:

- A) 6,1
- B) 6,5
- C) 6,6
- D) 7

Pyetja 30

Një klasë me 40 studentë ka 26 vajza. Do të zgjidhet një grup me 4 studentë. Probabiliteti që ky grup të përbëhet vetëm nga djem është:

- E) $\frac{C_{14}^4}{C_{40}^4}$
- F) C_{40}^4
- G) C_{14}^4

H) $\frac{C_{26}^4}{C_{40}^4}$

Pyetja 31

Nëse $P(A) = \frac{9}{20}$, $P(\bar{B}) = \frac{3}{5}$ dhe $P(A \cap B) = \frac{1}{4}$, atëherë $P(A \cup B)$ është:

A) $\frac{1}{3}$

B) $\frac{2}{3}$

C) $\frac{3}{5}$

D) $\frac{3}{20}$

Pyetja 32

Pagesa e punonjësve të një firme prodhuese jepet nga tabela:

Pagesa	Merret prej
30 000	1 përgjegjës
20 000	10 teknikë
16 000	15 punëtorë
10 000	5 operatorë

Paga mesatare është:

A) 15 000

B) 16 000

C) 16 774

D) 20 000

Pyetja 33

Pesha e një grupi fëmijësh jepet nga tabela.

Pesha (kg)	[35; 40)	[40; 45)	[45; 50)	[50; 55)
Efektivi	8	15	5	2

Mesatarja e kësaj shpërndarje statistikore është:

A) $\approx 37,5$

B) $\approx 42,5$

C) ≈ 50

D) $\approx 50,5$

Pyetja 34

Nëse $P(A) = \frac{1}{2}$, $P(B) = \frac{2}{3}$ dhe $P(A \cap B) = \frac{9}{10}$, atëherë $P(A \cup B)$ është:

A) $\frac{1}{3}$

B) $\frac{2}{3}$

C) $\frac{3}{5}$

D) $\frac{4}{15}$

Pyetja 35

Probabiliteti për të zgjedhur numrin 5555, nga të gjithë numrat katërshifror që fillojnë me 5, është:

A) $\frac{1}{100}$

B) $\frac{1}{1000}$

C) $\frac{1}{10000}$

D) $\frac{1}{10 \cdot 9 \cdot 8 \cdot 7}$

Pyetja 36

Në qoftë se $n(A) = 2x + 3$, $n(B) = 5x - 1$ dhe $n(A \cap B) = x + 1$, atëherë për $n(A \cup B)$ është i pamundur numri:

- A) 19
- B) 27
- C) 37
- D) 49

Pyetja 37

Shqyrtojmë provën e hedhjes së dy zareve. Nëse një nga zaret ka rënë 2, probabiliteti që zari tjetër të bjerë një numër më i madh se 2 është:

- A) $\frac{8}{11}$
- B) $\frac{8}{36}$
- C) $\frac{5}{36}$
- D) $\frac{11}{36}$

Pyetja 38

Me shifrat 0,1,2,3,4,5,6 formohen numra tek më të vegjël se 5000. Numri i tyre është:

- A) 500
- B) 610
- C) 735
- D) 805

Pyetja 39

Në një kuti janë vendosur 10 sfera të bardhë dhe 10 jeshilë. Nxirret rastësisht dy sfera njëherësh. Probabiliteti që ka të shumtën një jeshile, është:

- A) $\frac{29}{38}$
- B) $\frac{25}{38}$

C) $\frac{29}{100}$

D) 1,6

Pyetja 40

Në një kuti janë vendosur 10 sfera të bardhë dhe 10 jeshilë. Nxirret rastësisht dy sfera njëherësh. Probabiliteti që ka të paktën dy jeshile, është:

A) $\frac{29}{38}$

B) $\frac{9}{38}$

C) $\frac{29}{100}$

D) 0,6

Pyetja 41

Në një kuti janë vendosur 10 sfera të bardhë dhe 10 jeshilë. Nxirret rastësisht dy sfera njëherësh. Probabiliteti që sferat të jenë ngjyra të ndryshme, është:

A) $\frac{29}{38}$

B) $\frac{9}{38}$

C) $\frac{10}{19}$

D) $\frac{10}{38}$

Pyetja 42

Rezultatet e një studimi për gjatësinë e fëmijëve janë:
155 170 166 160 174 186 185 168 180 170
Devijimi standart i këtyre të dhënave është:

E) 8

- F) 9
- G) 10,12
- H) 12

Pyetja 43

Sa numra pozitivë tek më të vegjël se 10000 mund të shkruhen, duke përdorur shifrat 0,3,6,9:

- A) 100
- B) 110
- C) 120
- D) 128

Pyetja 44

Do të vendosim në raftet e bibliotekës 8 romane dhe 5 drama. Nëse vendosim në raftin e parë 4 romane dhe 2 drama, në sa mënyra mund të bëhet kjo vendosje:

- A) 700
- B) 710
- C) 720
- D) 800

Pyetja 45

Në një qese ndodhen 30 sfera, prej të cilave 8 janë të shënuara. Nxjerrim rastësisht 5 sfera. Probabiliteti që të dy sferat të jenë të shënuara është:

- A) $\frac{C_{8,2} \cdot C_{22,3}}{C_{30,5}}$
- B) $\frac{C_{8,2}}{C_{30,5}}$
- C) $\frac{C_{22,3}}{C_{30,5}}$

$$D) \frac{C_{8,2} + C_{22,3}}{C_{30,5}}$$

Pyetja 46

Në një qese ndodhen 8 sfera, nga të cilat 3 janë të kuqe, 1 e verdhë dhe të tjerat të pangjyrosura. Probabiliteti që një sferë e nxjerrë rastësisht të jetë e kuqe ose e verdhë është:

A) $\frac{3}{2}$

B) 1

C) $\frac{1}{2}$

D) $\frac{1}{4}$

Pyetja 47

Midis 6 vajzave dhe 5 djemve do të formohet grupi prej 4 personash. Probabiliteti që grupi i formuar rastësisht të ketë më shumë se 2 vajza është:

A) $\frac{20}{66}$

B) $\frac{23}{66}$

C) $\frac{63}{66}$

D) $\frac{1}{66}$

Pyetja 48

Nëse $2 \leq x \leq 3$ dhe $4 \leq y \leq 5$, mesatarja aritmetike më e vogël e numrave $\frac{1}{x}$ dhe $\frac{1}{y}$ është:

A) $\frac{1}{15}$

B) $\frac{2}{15}$

C) $\frac{3}{15}$

D) $\frac{4}{15}$

Pyetja 49

Mesatarja aritmetike e x , $x + 1$, $x + 4$ dhe $x + 7$ është 8. Mesorja e tyre është:

A) 6

B) 7

C) 7,5

D) 8

Pyetja 50

Mesatarja aritmetike e gjashtë numrave është 24. Nëse shuma e katër numrave është 96, mesatarja aritmetike e dy numrave të tjerë është:

A) 20

B) 24

C) 26

D) 30

Pyetja 51

Nota mesatare e një provimi të një grupi prej 30 studentësh është 7,6. Nota mesatare e djemve është 7, kurse e vajzave është 8. Numri i studentëve djem në këtë grup është:

A) 10

B) 12

C) 16

D) 20

Pyetja 52

Rezultatet e një provimi në një grup studentësh, jepen në tabelë:

Nota	3	4	5	6	7	8	9	10
Efektivi	1	3	6	12	8	2	5	3

Dispersioni i kësaj shpërndarje statistikore është:

- E) 0,8
- F) 1,052
- G) 2
- H) 3,04

Pyetja 53

Rezultatet e një provimi në një grup studentësh, jepen në tabelë:

Nota	3	4	5	6	7	8	9	10
Efektivi	1	3	6	12	8	2	5	3

Shmangia mesatare katrore e kësaj shpërndarje statistikore është:

- A) $\sqrt{2}$
- B) $\sqrt{3,04}$
- C) $\sqrt{6}$
- D) 2

Pyetja 54

Zgjidhja e ekuacionit $5 \cdot C_n^3 = C_{n+2}^4$ është:

- A) {2; 7}
- B) {3; 7}
- C) {3; 14}
- D) {7; 9}

Pyetja 55

Pesha e një grupi fëmijësh jepet nga tabela.

Pesha (kg)	[35; 40)	[40; 45)	[45; 50)	[50; 55)
Efektivi	8	15	5	2

Dispersioni i kësaj shpërndarje statistikore është:

- E) $\approx 17,5$
- F) $\approx 22,5$
- G) ≈ 30
- H) $\approx 30,5$

Pyetja 56

Pesha e një grupi fëmijësh jepet nga tabela.

Pesha (kg)	[35; 40)	[40; 45)	[45; 50)	[50; 55)
Efektivi	8	15	5	2

Shmangia mesatare katrore e kësaj shpërndarje statistikore është:

- A) $\approx 3,5$
- B) ≈ 5
- C) $\approx 4,2$
- D) $\approx 6,5$

Pyetja 57

Probabilitetet e kalimit në tre provime të një studenti janë 0,8; 0,7 dhe 0,6. Probabiliteti që studenti të kalojë të paktën në dy lëndë është:

- A) $\approx 0,65$
- B) $\approx 1,08$
- C) $\approx 0,5$
- D) $\approx 0,486$

Pyetja 58

Nga bashkësia $A = \{1,2,3,\dots,15\}$ zgjidhen rastësisht 2 numra që shuma e tyre të jetë 4ift. Probabiliteti që të dy numrat të jenë tek, është:

- A) $\frac{1}{3}$
- B) $\frac{4}{7}$
- C) $\frac{3}{5}$
- D) 2

Pyetja 59

Jepet ndryshorja e rastit me shpërndarje normale $X \sim N(8; 16)$ dhe me vëllim $n = 49$, për nivel besueshmërie 95%. Vlerësimi intervalor i mesatares së zgjedhjes është:

- A)]5; 8[
- B)]6; 8[
- C)]6,88; 9,12[
- D)]6,88; 8[

Pyetja 60

Sipas parashikimit të motit sot do të bjerë ose shi, ose borë, por nuk mund të ndodhin të dy ngjarjet njëherësh. Probabiliteti që të bjerë shi është $\frac{2}{5}$, ndërsa për të rënë borë është $\frac{3}{5}$. Nëse bie shi, probabiliteti që unë të vonohem në punë është $\frac{1}{5}$, ndërsa po të bjerë borë është $\frac{3}{5}$. Probabiliteti që të vonohem në punë është:

- A) $\frac{11}{20}$
- B) $\frac{11}{30}$
- C) $\frac{11}{25}$
- D) $\frac{25}{11}$

Pyetja 61

Në kutinë A ka 1 sferë të kuqe dhe 2 të zinj. Në kutinë B ka 2 sfera të kuqe dhe 1 të zi. Në fillim zgjidhet një kuti. Probabiliteti për të zgjedhur kutina A është $\frac{1}{3}$, ndërsa kutinë B është $\frac{2}{3}$. Nga kutia e zgjedhur nxirren njëri pas tjetrit me kthim 3 sfera. Probabiliteti i ngjarjes sfera e tretë e nxjerrë është e zezë, është:

A) $\frac{1}{9}$

B) $\frac{2}{9}$

C) $\frac{3}{9}$

D) $\frac{4}{9}$

Pyetja 62

Në kutinë A ka 1 sferë të kuqe dhe 2 të zinj. Në kutinë B ka 2 sfera të kuqe dhe 1 të zi. Në fillim zgjidhet një kuti. Probabiliteti për të zgjedhur kutina A është $\frac{1}{3}$, ndërsa kutinë B është $\frac{2}{3}$. Nga kutia e zgjedhur nxirren njëri pas tjetrit me kthim 3 sfera. Probabiliteti i ngjarjes që sfera e tretë është e zezë kur edhe dy të parët janë të zinj, është:

A) $\frac{2}{9}$

B) $\frac{3}{9}$

C) $\frac{4}{9}$

D) $\frac{5}{9}$

Pyetja 63

Në një reparat tri makina M_1 , M_2 dhe M_3 prodhojnë të njëjtin detal. Makina M_1 jep 40% të prodhimit, M_2 jep 35% dhe M_3 25% të prodhimit. Në prodhimin e secilës makinë pjesa me defekt është 5%, 3% dhe 4% përkatësisht. Detalet grumbullohen në një magazinë pa u ndarë. Probabiliteti që një detal i zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga magazina të jetë me defekt, është:

A) 0,5

- B) 0,01
- C) 0,045
- D) 1

Pyetja 64

Në një reparat tri makina M_1 , M_2 dhe M_3 prodhojnë të njëjtin detal. Makina M_1 jep 40% të prodhimit, M_2 jep 35% dhe M_3 25% të prodhimit. Në prodhimin e secilës makinë pjesa me defekt është 5%, 3% dhe 4% përkatësisht. Detalet grumbullohen në një magazinë pa u ndarë. Zgjidhet një detal në mënyrë të rastësishme dhe ai është me defekt. Probabiliteti që detali i zgjedhur me defekt të jetë prodhuar nga makina M_1 , është:

- A) 0,5
- B) 0,44
- C) 0,045
- D) 0,02

Pyetja 65

Në një qytet me $(n + 1)$ banorë, dikush i tregon një histori një tjetri, i cili ia tregon një tjetri, e kështu me radhë. Në çdo hap, personi të cilit i tregohet ndodhia zgjidhet rastësisht. Ndodhia tregohet r herë. Probabiliteti që historia nuk do t'i tregohet të parit, është:

- A) $1 - \frac{1}{n}$
- B) $\left(1 - \frac{1}{n}\right)^r$
- C) $\left(1 - \frac{1}{n}\right)^{r-1}$
- D) $\left(\frac{1}{n}\right)^r$

Pyetja 66

Në një qytet me $(n + 1)$ banorë, dikush i tregon një histori një tjetri, i cili ia tregon një tjetri, e kështu me radhë. Në çdo hap, personi të cilit i tregohet ndodhia zgjidhet rastësisht. Ndodhia tregohet r herë. Probabiliteti që historia nuk do t'i tregohet dy herë të njëjtit person, është:

A) $1 - \frac{1}{n}$

B) $\left(1 - \frac{1}{n}\right)\left(1 - \frac{2}{n}\right)$

C) $\left(1 - \frac{1}{n}\right)^{1-r}$

D) $\left(1 - \frac{1}{n}\right)\left(1 - \frac{2}{n}\right)\dots\left(1 - \frac{r-1}{n}\right)$

Pyetja 67

Një zar i rregullt hidhe dy herë. Shënojmë me A ngjarjen: “herën e parë zari ka rënë 3” dhe B: “shuma e dy numrave të rënë është 6”. Probabiliteti me kusht B kur ka ndodhur A, është:

A) $\frac{1}{6}$

B) $\frac{2}{6}$

C) $\frac{3}{6}$

D) $\frac{5}{6}$

Pyetja 68

Një zar i rregullt hidhe dy herë. Shënojmë me A ngjarjen: “herën e parë zari ka rënë 3” dhe B: “shuma e dy numrave të rënë është 6”. Probabiliteti me kusht A kur ka ndodhur B, është:

A) $\frac{1}{5}$

B) $\frac{2}{5}$

C) $\frac{3}{5}$

D) $\frac{4}{5}$

PROBABILITET DHE STATISTIKË(pjesa e dytë)

Pyetja 1

Nëse $P(A) = 0.5$, $P(B) = 0.6$ dhe $P(AB) = 0.2$, atëherë $P(A \cup B)$ është:

- A) 0.5
- B) 0.7
- C) 0.9
- D) 0.2

Pyetja 2

Nëse $P(A) = 0.5$, $P(B) = 0.6$, A dhe B të pavarura, atëherë $P(\overline{A \cap B})$ është:

- A) 0.7
- B) 0.1
- C) 0.3
- D) 0.8

Pyetja 3

Vlera e $\frac{20!}{0!19!}$ është:

- A) 0
- B) 19!
- C) 20
- D) 19

Pyetja 4

Kemi 20 të ftuar të cilët do të ulen në një tavolinë rrumbullake me njëzet karrike. Në sa mënyra mund të ulen ata?

- A) 20!
- B) 10!
- C) 19!
- D) 200

Pyetja 5

C_{60}^3 është e barabartë me:

- A) C_{60}^{57}
- B) C_{60}^{30}
- C) C_{60}^{16}
- D) C_{60}^{45}

Pyetja 6

Cila nga përgjigjet e mëposhtme është e vërtetë:

- A) $P(A/B)$ është probabiliteti i ngjarjes A pjesuar me probabilitetin e ngjarjes B
- B) $P(A/B)$ është probabiliteti i ngjarjes A me kusht që të ketë ndodhur B
- C) $P(A/B)$ është probabiliteti i ngjarjes B me kusht që ka ndodhur A
- D) $P(A/B)$ është probabiliteti i diferencës së dy ngjarjeve A dhe B

Pyetja 7

Ngjarjet A dhe B janë të papajtueshme të tilla që, $P(A) = 0.75$ dhe $P(B) = \frac{1}{4}$.

Atëherë probabiliteti $P(A \cup B)$ është:

- A) 0.4
- B) 1
- C) 0.8
- D) 0.9

Pyetja 8

Në qoftë se kemi dy ngjarje A dhe B të pavarura nga njëra tjetra dhe $A = B$, atëherë $P(A)$ është:

- A) 0
- B) 1
- C) 0 ose 1
- D) vlerë midis 0 dhe 1

Pyetja 9

Ngjarja A sjell ngjarjen

Bshkruhet:

- A) $A \subset B$
- B) $A \in B$
- C) $B \subset A$
- D) $B \cup A$

Pyetja 10

Në qoftë se kemi n ngjarje $A_1, A_2, A_3, \dots, A_n$, atëherë ndodh të paktën njëra shënohet:

- A) A_n
- B) $\bigcup_{i=1}^n A_i$
- C) $\prod_{i=1}^n A_i$
- D) $\bigcap_{i=1}^n A_i$

Pyetja 11

Në qoftë se kemi n ngjarje $A_1, A_2, A_3, \dots, A_n$, atëherë ndodhin të gjitha shënohet:

- A) A_n
- B) $\bigcup_{i=1}^n A_i$
- C) $\prod_{i=1}^n A_i$
- D) $\bigcap_{i=1}^n A_i$

Pyetja 12

Numri X tregon numrin e pikëve të rëna kur hidhet një zar i rregullt. Shpërndarja e numrit $Y = X^2 - 2$ është:

- A) 1, 2, 7, 14, 23, 34
- B) -1, 2, 7, 14, 23, 34
- C) 1, 4, 9, 16, 25, 36
- D) 2, 7, 14, 16, 23, 34

Pyetja 13

Nëse $E(X) = 100$, atëherë $E(-2X + 5)$ është:

- A) -195
- B) 195
- C) 200
- D) 205

Pyetja 14

Nëse $D(X) = 15$, atëherë $D(-4X + 5)$ është:

- A) 60
- B) 65
- C) 55
- D) 245

Pyetja 15

Pritja matematike e ndryshores së rastit $X \sim B(10, 3/5)$ është:

- A) -6
- B) 6
- C) $\frac{3}{5}$
- D) $\frac{5}{3}$

Pyetja 16

Dispersioni i ndryshores së rastit $X \sim B(10, 3/5)$ është:

- A) 12
- B) -12
- C) 21
- D) -21

Pyetja 17

Pritja matematike e ndryshores së rastit $X \sim N(-4, 16)$ është:

- A) 16
- B) -16
- C) 4
- D) -4

Pyetja 18

Dispersioni i ndryshores së rastit $X \sim N(-4, 16)$ është:

- A) 4
- B) 20
- C) 16
- D) 12

Pyetja 19

Në qoftë se X dhe Y janë dy ndryshore rasti të pavarura , atëhere $cov(X, Y)$ është:

- A) 1
- B) -1
- C) 0
- D) $\frac{1}{2}$

Pyetja 20

PS)B

Pyetja 56 V)1

Në ceremoninë e hapjes së një dyqani, çdo blerës kishte një shanc për të fituar duke tërhequr një biletë nga 100 biletat e vendosura në një kuti. 20 prej tyre shkuajnë “Fituat” dhe të tjerat “Provoni përsëri”. Supozojmë që dy blerës luajnë dhe bileta që tërheq blerësi i parë NUK rikthehet përsëri në kuti, atëherë probabiliteti që blerësi i dytë të humb duke ditur që edhe blerësi i parë ka fituar, është:

- A) $\frac{4}{5}$
- B) $\frac{79}{99}$
- C) $\frac{80}{99}$
- D) $\frac{80}{100}$

PS)C

Pyetja 57 V)1

Në ceremoninë e hapjes së një dyqani, çdo blerës kishte një shanc për të fituar duke tërhequr një biletë nga 100 biletat e vendosura në një kuti. 20 prej tyre shkuajnë “Fituat” dhe të tjerat “Provoni përsëri”. Supozojmë që dy blerës luajnë dhe bileta që tërheq blerësi i parë NUK rikthehet përsëri në kuti, atëherë probabiliteti që blerësi i dytë të fitoj duke ditur që edhe blerësi i parë ka humbur, është:

- A) $\frac{1}{5}$
- B) $\frac{19}{99}$
- C) $\frac{20}{99}$
- D) $\frac{80}{100}$

PS)C

Pyetja 58 V)1

Në ceremoninë e hapjes së një dyqani, çdo blerës kishte një shanc për të fituar duke tërhequr një biletë nga 100 biletat e vendosura në një kuti. 20 prej tyre shkuajnë “Fituat” dhe të tjerat “Provoni përsëri”. Supozojmë që dy blerës luajnë dhe bileta që tërheq blerësi i parë NUK rikthehet përsëri në kuti, atëherë probabiliteti që blerësi i dytë të humbas duke ditur që edhe blerësi i parë ka humbur, është:

- A) $\frac{1}{5}$
- B) $\frac{79}{99}$
- C) $\frac{19}{99}$
- D) $\frac{20}{99}$

PS)B

Pyetja 59 V)1

Në tabelë jepen probabiliteti për të fituar një çmim në një lojë.

Çmimi i fituar (në 000 L)	0	1	10	100
Probabiliteti	0.7	0.25	0.04	0.01

Probabiliteti për të fituar 10 000 L ose më shumë është:

- A) 0.01
- B) 0.04
- C) 0.05
- D) 0.7

PS)C

Pyetja 60 V)1

Në tabelë jepen probabiliteti për të fituar një çmim në një lojë.

Çmimi i fituar (në 000 L)	0	1	10	100
Probabiliteti	0.7	0.25	0.04	0.01

Probabiliteti për të fituar më pak se 10 000 L është:

- A) 0.95
- B) 0.99
- C) 0.7
- D) 0.25

PS)A

Pyetja 61 V)2

Nëse $P(A) = 0.5$, $P(B) = 0.6$ dhe $P(AB) = 0.2$, atëherë $P(A \cup \bar{B})$ është:

- A) 0.4
- B) 0.6

- C) 0.5
- D) 0.9

PS)B

Pyetja 62 V)2

Hidhet një zar dy herë. Pikët shënohen në një letër. Në qoftëse shënojmë me a rezultatin e parë dhe me b rezultatin e dytë, probabiliteti i ngjarjes $\max(a,b) > 4$ është:

- A) $\frac{12}{36}$
- B) $\frac{5}{9}$
- C) $\frac{25}{36}$
- D) $\frac{4}{9}$

PS)B

Pyetja 63 V)2

Hidhet një zar dy herë. Pikët shënohen në një letër. Në qoftëse shënojmë me x rezultatin e parë dhe me y rezultatin e dytë, probabiliteti i ngjarjes $|x - y| = 2$ është:

- A) $\frac{12}{36}$
- B) $\frac{5}{9}$
- C) $\frac{25}{36}$
- D) $\frac{2}{9}$

PS)D

Pyetja 64 V)2

Duhet të zgjidhni në klasën tuaj bordin e klasës prej pesë vetësh dhe dy prej bordit të zgjidhen për ta kryesuar atë. Nëse klasa juaj ka 35 nxënës, atëherë numri i mundshëm i zgjedhjeve është:

- A) $C_{35}^5 \cdot C_5^2$
- B) $C_{35}^3 \cdot C_5^2$
- C) $C_{35}^5 \cdot C_{35}^2$

D) $C_{35}^3 \cdot C_5^2$

PS)A

Pyetja 65 V)2

Në një kuti ka 6 sfera të kuqe, 4 të bardha dhe 8 të zeza. Tërhiqen rastësisht dy sfera njëherësh. Probabiliteti që njëra nga sferat të jetë e bardhë dhe tjetra e zezë është:

- A) 0.42
- B) 0.234
- C) 0.209
- D) 0.54

PS)C

Pyetja 66 V)2

Kemi 10 detale nga të cilat 4 janë me difekt. Zgjedhim 3 detale pa kthim. Probabiliteti që të kemi nxjerrë dy detale me difekt është:

- A) 0.4
- B) 0.2
- C) 0.8
- D) 0.3

PS)D

Pyetja 67 V)2

Në një kuti ka 6 sfera të kuqe, 4 të bardha dhe 8 të zeza. Tërhiqen rastësisht dy sfera njëra pas tjetres pa kthim. Probabiliteti që njëra nga sferat të jetë e bardhë dhe tjetra e zezë është:

- A) 0.105
- B) 0.304
- C) 0.450
- D) 0.850

PS)A

Pyetja 68 V)2

Në një kuti ka 6 sfera të kuqe, 4 të bardha dhe 8 të zeza. Tërhiqen rastësisht dy sfera njëra pas tjetres me kthim. Probabiliteti që njëra nga sferat të jetë e bardhë dhe tjetra e zezë është:

- A) 0.98
- B) 0.098

- C) 0.036
- D) 0.58

PS)B

Pyetja 69 V)2

A dhe B janë ngjarje të pavarura të tilla që $P(A) = 0.2$, $P(B) = 0.5$. Atëherë $P(\overline{A} \cap \overline{B})$ është:

- A) 0.4
- B) 0.2
- C) -0.4
- D) 0.7

PS)A

Pyetja 70 V)2

Një zar i rregullt hidhet 6 herë njëra pas tjetrës. Probabiliteti që të paktë një herë do të bjerë 5 është:

- A) $\frac{5}{6}$
- B) $\left(\frac{5}{6}\right)^5$
- C) $1 - \left(\frac{5}{6}\right)^6$
- D) $\left(\frac{1}{6}\right)^5$

PS)C

Pyetja 71 V)2

Një monedhë hidhet 10 herë. Probabiliteti që ajo të 10 herët të bjerë kokëeshtë:

- A) $\frac{2}{5}$
- B) $\frac{1}{2}$
- C) $\left(\frac{1}{2}\right)^{10}$
- D) $-\frac{1}{2}$

PS)C

Pyetja 72 V)2

Hidhet një monedhë e rregullt 20 herë. Sa rezultate të mundshme ka që monedha të bjerë 7 herë stemë?

- A) C_{20}^2
- B) C_7^2
- C) C_{20}^7
- D) C_{20}^9

PS)C

Pyetja 73 V)2

Në qoftë se kemi 12 pyetje nga të cilat vetëm 6 prej tyre janë nga letërsia, të tjerat janë nga lëndë të ndryshme dhe zgjedhim njëra pas tjetrës me kthim katër pyetje, atëherë probabiliteti që të jenë tre prej tyre nga letërsia është:

- A) $\frac{3}{2}$
- B) $\frac{1}{4}$
- C) $\frac{3}{4}$
- D) $\frac{1}{2}$

PS)B

Pyetja 74 V)2

Një ndryshore rasti X ka densitet si në tabelë.

X	0	1	2	4
P(X=x)	1/3	1/3	1/6	1/6

Pritja matematike është:

- A) $\frac{4}{3}$
- B) $\frac{3}{4}$
- C) $\frac{1}{6}$

D) $\frac{3}{2}$

PS)A

Pyetja 75 V)2

Një ndryshore rasti X ka densitet si në tabelë.

X	0	1	2	4
P(X=x)	1/3	1/3	1/6	1/6

Dispersioni është:

A) $\frac{17}{36}$

B) $\frac{10}{36}$

C) $\frac{17}{9}$

D) $\frac{3}{36}$

PS)C

Pyetja 76 V)2

Një profesor korrigjoi 32 provime dhe gjeti se nota mesatare është 7.2 ndërsa mesorja është 8. Nota më e vogël është 4 dhe më e madhja është 9. Ai mendon t'i rrisë të gjitha notat me një njësi.

Atëherë mesorja:

A) Nuk ndryshon

B) Rritet

C) Zvogëlohet

D) Asnjëra

PS)B

Pyetja 77 V)2

Një profesor korrigjoi 32 provime dhe gjeti se nota mesatare është 7.2 ndërsa mesorja është 8. Nota më e vogël është 4 dhe më e madhja është 9. Ai mendon t'i rrisë të gjitha notat me një njësi.

Atëherë mesatarja:

A) Nuk ndryshon

B) Zvogëlohet

C) Rritet

D) Asnjëra

PS)C

Pyetja 78 V)2

Një profesor korrigjoi 32 provime dhe gjeti se nota mesatare është 7.2 ndërsa mesorja është 8. Nota më e vogël është 4 dhe më e madhja është 9. Ai mendon t'i rrisë të gjitha notat me një njësi. Atëherë devijimi standart:

- A) Nuk ndryshon
- B) Zvogëlohet
- C) Rritet
- D) Asnjëra

PS)A

Pyetja 79 V)2

Në një eksperiment u mat gjatësia e disa insekteve. Të dhënat tregohen më poshtë:

Gjatësia në cm	30	34	36	38
Numri i insekteve	7	5	5	10

Përqindja e insekteve që e kanë gjatësinë më të vogël së gjatësia mesatare është:

- A) 50%
- B) 44.4%
- C) 50.4%
- D) 50.5%

PS)B

Pyetja 80 V)2

Realizimi i normës për punëtorë është dhënë si më poshtë.

Reslizimi i normës në %	deri 75	75-80	80-85	85-90	90-95	95-100	100-105	mbi 105
Numri i punëtorëve	6	8	18	42	60	32	22	12
Denduritë rritëse	6	13	31	73	133	165	187	199

Mesorja e tyre është:

- A) 90
- B) 92.5
- C) 80
- D) 82.5

PS)B

Pyetja 81 V)2

Më poshtë është dhënë shpërndarja e pagave të menaxherëve të 50 kompanive (në mijë lekë):

Paga	30-54	55-79	80-104	105-129	130-154	155-179
Nr i menaxherëve	3	21	19	3	1	3
Mesi i klasave	42	66	90	114	138	162

Mesatarja e tyre është:

- A) 80
- B) 83.76
- C) 70
- D) 73.76

PS)B

Pyetja 82 V)2

Në një ndërmarrje kanë mbajtur shënim numrin e ankesave të kryera pranë saj në muajt e fundit. Rezultatet tregohen si më poshtë:

Numri i ankesave	0	1	2	3	4
Numri i ditëve	39	35	18	6	2

Sa përqind të ditëve ka të paktën dy ankesa në ditë:

- A) 90%
- B) 30%
- C) 26%
- D) 96%

PS)C

Pyetja 83 V)2

Në një ndërmarrje kanë mbajtur shënim numrin e ankesave të kryera pranë saj në muajt e fundit. Rezultatet tregohen si më poshtë:

Numri i ankesave	0	1	2	3	4
Numri i ditëve	39	35	18	6	2

Sa përqind të ditëve ka të shumtën dy ankesa në ditë:

- A) 92%
- B) 30%
- C) 26%
- D) 96%

PS)A

Pyetja 84 V)2

Në se pyesim një grup fëmijësh se sa dhurata kanë marrë për Vitin e Ri, marrim të dhënat: mesatarja e tyre është 20 dhurata dhe devijimi standart është 4 dhurata. Me nivel besueshmërie 68% numri minimal i dhuratave të marra është:

- A) 20
- B) 16
- C) 24
- D) 18

PS)B

Pyetja 85 V)2

Në se numri mesatar i ankesave për rishikim provimi nga studentët është 20 dhe devijimi standart 3. Sa është numri maksimal i kërkesave për rishikim provimi në lidhje më një nivel besueshmërie 95%:

- A) 20
- B) 26
- C) 17
- D) 23

PS)B

Pyetja 86 V)2

Në se numri mesatar i shtrimeve në një spital është 10 pacientë në ditë dhe dedijimi standart 3, atëherë cili është numri minimal dhe maksimal i shtrimeve në një ditë duke marrë parasysh shansin e gabimit 1%:

- A) 7-13
- B) 4-16
- C) 1-19
- D) 1-16

PS)C

Pyetja 87 V)2

Monedha hidhet 40 herë. Probabiliteti që ajo të bjerë 20 herë stemë është:

- A) 0.1
- B) 0.2
- C) 0.5

D) 0.125

PS)D

Pyetja 88 V)2

Nëse një zar i rregullt hidhet 10 herë. Vlera e pritshme mbas 10 herësh do të jetë:

A) $\frac{1}{2}$

B) 60

C) $\frac{10}{6}$

D) 5

PS)C

Pyetja 89 V)2

Nëse një monedhë hidhet disa here, duke ditur se vlera e pritshme mbas disa hedhjesh është 8, atëherë devijimi standart do të jetë:

A) 4

B) 6

C) 2

D) 0

PS)C

Pyetja 90 V)2

Diagrami kuti dhe mustaqe shërben për të tregua:

A) cilat të dhëna janë më të përsëritura

B) sa ndryshim ka midis mesores dhe mesatares

C) sa ndryshim ka midis mesores dhe modës

D) si janë shpërndarë të dhënat në lidhje me mesoren

PS)D

Pyetja 91 V)2

Në qoftë se kemi gjithsej 15 të dhëna të renditura nga më i vogli tek më i madhi. Atëhere mesorja është:

A) çdo numër midis x_7 dhe x_8

B) $\frac{7+8}{2}$ $(7+8)/2$

C) vetëm $\frac{x_7 + x_8}{2}$

D) 7,5

PS)A

Pyetja 92 V)2

Duam të studiojmë tregun e makinave të përdorura për të bërë një parashikim për të ardhmen në lidhje me numrin e shitjeve të tyre. Nga studimi i bërë me më shumë se 6 makina u morën rezultatet e mëposhtme:

Çmimi i makinës (në milion)	5	15	10	8	6	12
Nr i kilometrave	20000	2000	5000	10000	7000	6000

Në këtë rast koeficienti i korelacionit është:

A) 0.78

B) 0.5

C) -0.78

D) -0.5

PS)C

Pyetja 93 V)2

Duam të studiojmë tregun e makinave të përdorura për të bërë një parashikim për të ardhmen në lidhje me numrin e shitjeve të tyre. Nga studimi i bërë me më shumë se 6 makina u morën rezultatet e mëposhtme:

Çmimi i makinës (në milion)	5	15	10	8	6	12
Nr i kilometrave	20000	2000	5000	10000	7000	6000

Atëherë koeficienti i përcaktueshmërisë është:

A) 61%

B) 0.061

C) -0.61

D) 0.6

PS)A

Pyetja 94 V)2

Çmimi i një makine që ka bërë 5000 km të njehsuar me ekuacionin e regresit $y = 13.2 - 0.0005x$ është:

- A) 10.2 (milionë)
- B) 10.3 (milionë)
- C) 10.5 (milionë)
- D) 10.7 (milionë)

PS)D

Pyetja 95 V)2

U mat tretshmëria e një lloj kripe në 100g ujë në temperaturë të ndryshme ($^{\circ}\text{C}$). Të dhënat janë si më poshtë:

Temperatura	0	10	20	30	40	50	60	70
Pesha	63.5	59.5	65.2	70.6	75.5	80.2	85.5	90

Në qotë se drejtëza e regresit mbi këto të dhëna është $y = 58.5 + 0.4x$, atëherë sasia e kripës që do jetë tretur në ujë në temperaturën 55°C do jetë:

- A) 50.5
- B) 80.5
- C) 70.5
- D) 90.5

PS)B

Pyetja 96 V)2

U mat tretshmëria e një lloj kripe në 100g ujë në temperaturë të ndryshme ($^{\circ}\text{C}$). Të dhënat janë si më poshtë:

Temperatura	0	10	20	30	40	50	60	70
Pesha	63.5	59.5	65.2	70.6	75.5	80.2	85.5	90

Në qotë se drejtëza e regresit mbi këto të dhëna është $y = 58.5 + 0.4x$, atëherë sasia e tretur në temperaturën 20°C nuk e vërteton ekuacionin sepse:

- A) Të gjitha të dhënat kalojnë nga drejtëza e regresit
- B) Kjo e dhënë korespondon me mesataren e të dhënave
- C) Drejtëza e regresit kalon nga mesataret e grupit të të dhënave
- D) 20°C janë shumë më pak se temperature mesatare

PS)C

Pyetja 97 V)2

Mediana e të dhënave në tabelë, është:

Pesha	10	11	12	13	14	15	16
-------	----	----	----	----	----	----	----

Denduria	2	4	5	6	8	7	3
----------	---	---	---	---	---	---	---

- A) 12
- B) 13
- C) 14
- D) 15

PS)C

Pyetja 98 V)2

Jepen të dhënat: 2, 3, 3, 4, 6, 7, 8, 8, 9, 10, 12. Diferenca midis dy kuartileve është:

- A) 5
- B) 6
- C) 7
- D) 10

PS)A

Pyetja 99 V)2

Jepen të dhënat: 2, 3, 3, 4, 6, 7, 8, 8, 9, 10, 12. Varianca e tyre është:

- A) 3.114
- B) 4.2
- C) 9.697
- D) 10

PS)C

Pyetja 100 V)2

Jepen të dhënat: 2, 3, 3, 4, 6, 7, 8, 8, 9, 10, 12. Devijimi standart i tyre është:

- A) 3.114
- B) 4.2
- C) 9.697
- D) 10

PS)A

Pyetja 101 V)2

Nëse të dhënat: 2, 3, 3, 4, 6, 7, 8, 8, 9, 10, 12, kanë devijimin standart 4, atëherë varianca e tyre është:

- A) -2 ose 2

- B) 2
- C) 16 ose 10
- D) 16

PSD

Pyetja 102 V)2

Nëse të dhënat: 2, 3, 3, 4, 6, 7, 8, 8, 9, 10, 12, kanë variancë 9, atëherë devijimin standart i tyre është:

- A) -3 ose 3
- B) 3
- C) -9 ose 9
- D) 81

PS)B

Pyetja 103 V)2

Një analist i tregut të aksioneve ka studiuar varësinë e pagimit të dividendit në varësi të rritjes ose uljes së çmimit të aksioneve. Rezultati i vrojtimit të tij është si më poshtë:

	Çmimi rritet	Çmimi zvogëlohet	Totali
Dividenti paguhet	34	78	112
Dividenti nuk paguhet	85	49	134
Totali	119	127	246

Nëse zgjidhet rastësisht një aksion, probabiliteti që atij t'i rritet çmimi është:

- A) 0.4
- B) 0.48
- C) 0.6
- D) 1

PS)B

Pyetja 104 V)2

Një analist i tregut të aksioneve ka studiuar varësinë e pagimit të dividendit në varësi të rritjes ose uljes së çmimit të aksioneve. Rezultati i vrojtimit të tij është si më poshtë:

	Çmimi rritet	Çmimi zvogëlohet	Totali
Dividenti paguhet	34	78	112
Dividenti nuk paguhet	85	49	134
Totali	119	127	246

Nëse zgjidhet rastësisht një aksion, probabiliteti që dividenti të jetë paguar është:

- A) 0.4
- B) $\frac{1}{4}$
- C) $\frac{17}{41}$
- D) $\frac{112}{134}$

PS)C

Pyetja 105 V)2

Një analist i tregut të aksioneve ka studiuar varësinë e pagimit të dividendit në varësi të rritjes ose uljes së çmimit të aksioneve. Rezultati i vrojtimit të tij është si më poshtë:

	Çmimi rritet	Çmimi zvogëlohet	Totali
Dividenti paguhet	34	78	112
Dividenti nuk paguhet	85	49	134
Totali	119	127	246

Nëse zgjidhet rastësisht një aksion, probabiliteti që të kemi rritje çmimi dhe dividend të paguar njëkohësisht është:

- A) 0.2
- B) $\frac{34}{112}$
- C) $\frac{78}{112}$
- D) $\frac{34}{246}$

PS)D

Pyetja 106 V)2

Një analist i tregut të aksioneve ka studiuar varësinë e pagimit të dividendit në varësi të rritjes ose uljes së çmimit të aksioneve. Rezultati i vrojtimit të tij është si më poshtë:

	Çmimi rritet	Çmimi zvogëlohet	Totali
Dividenti paguhet	34	78	112
Dividenti nuk paguhet	85	49	134
Totali	119	127	246

Nëse zgjidhet rastësisht një aksion, probabiliteti që nuk kemi rritje çmimi dhe dividendi nuk është paguar është:

- A) $\frac{49}{246}$
- B) $\frac{34}{112}$

- C) $\frac{78}{112}$
 D) $\frac{34}{246}$

PS)A

Pyetja 107 V)2

Një analist i tregut të aksioneve ka studiuar varësinë e pagimit të dividendit në varësi të rritjes ose uljes së çmimit të aksioneve. Rezultati i vrojtimit të tij është si më poshtë:

	Çmimi rritet	Çmimi zvogëlohet	Totali
Dividenti paguhet	34	78	112
Dividenti nuk paguhet	85	49	134
Totali	119	127	246

Dimë që për një aksion kemi rritje çmimi. Probabiliteti që çmimi i aksionit të jetë rritur është:

- A) $\frac{49}{246}$
 B) $\frac{34}{119}$
 C) $\frac{78}{112}$
 D) $\frac{34}{246}$

PS)B

Pyetja 108 V)3

Ju keni një takim në orën 8:00. Për këtë arsye ju keni vënë orën në zile pa e ditur se ora juaj është 10 minuta mbrapa. Probabiliteti që të bjerë zilja është $\frac{2}{3}$, ndërsa që të mos bjerë është $\frac{1}{3}$. Po të bjerë zilja, probabiliteti që të vonohesh në takim është $\frac{1}{4}$, ndërsa në rastin kur nuk bie zilja probabiliteti për tu vonuar është $\frac{3}{4}$. Probabiliteti që ju të vonoheni në leksion është:

- A) $\frac{2}{12}$
 B) $\frac{5}{12}$
 C) $\frac{3}{12}$
 D) $\frac{4}{12}$

PS)B

Pyetja 109 V)3

Keni 30 pyetje provimi që duhet t'i zgjidhni për t'i mësuar. Një nxënës i ka zgjidhur ato dhe disa të tjerë i marrin të gatshme. Në pyetjet e zgjidhura 10 prej tyre janë zgjidhur gabim. Atëherë profesori i merr pyetjet njëra pas tjetrës për ti kontrolluar zgjidhjen. Probabiliteti që herën e dytë do të dalë një pyetje e zgjidhur gabimëshhtë:

A) $\frac{1}{3}$

B) $\frac{2}{3}$

C) $\frac{4}{3}$

D) $\frac{1}{2}$

PS)A

Pyetja 110 V)3

Hidhet një zar i rregullt dy herë. Probabiliteti i ngjarjeje: “Shuma e pikëve të rëna të jetë të paktën shtatë” është:

A) $\frac{2}{13}$

B) $\frac{4}{13}$

C) $\frac{5}{13}$

D) $\frac{7}{13}$

PS)D

Pyetja 111 V)3

Hidhet zari i rregullt dy herë. Dihet se njëherë ka rënë numri 1. Probabiliteti që shuma e pikëve të rëna të jetë të paktën shtatë është:

A) $\frac{2}{18}$

B) $\frac{1}{18}$

C) $\frac{7}{18}$

D) $\frac{4}{36}$

PS)B

Pyetja 112 V)3

Hidhet një monedhë jo e rregullt, e tillë që probabiliteti për të rënë kokë është $1/5$. Po të bjerë kokë zgjidhet një numër nga 1 në 5 (duke e përfshirë 5). Po të bjerë pil hidhet një zar i rregullt. Probabiliteti që numri i rënë të jetë numër tekështë:

- A) 0.45
- B) 0.52
- C) 0.82
- D) 0.75

PS)B

Pyetja 113 V)3

Hidhet monedha e rregullt 20 herë. Probabiliteti që stema të bjerë të paktën 5 herë është:

- A) $\frac{1}{2^{20}} \cdot \sum_{i=5}^{20} C_{20}^i$
- B) $\frac{1}{2^{20}} \cdot \sum_{i=1}^{20} C_{20}^i$
- C) $\frac{1}{2^{20}} \cdot \sum_{i=5}^{20} C_{20}^5$
- D) $\frac{1}{2^5} \cdot \sum_{i=5}^{20} C_{20}^i$

PS)A

Pyetja 114 V)3

Hidhet monedha e rregullt 20 herë. Probabiliteti që stema të bjerë më shumë se 5 herë është:

- A) $1 - \frac{1}{2^{20}} \cdot \sum_{i=5}^{20} C_{20}^i$
- B) $1 - \frac{1}{2^{20}} \cdot \sum_{i=1}^{20} C_{20}^i$
- C) $\frac{1}{2^{20}} \cdot \sum_{i=5}^{20} C_{20}^5 - 1$

$$D) \frac{1}{2^5} \cdot \sum_{i=5}^{20} C_{20}^i$$

PS)A

Pyetja 115 V)3

Dy vetë hedhin një monedhë 8 herë secili. Monedha është e rregullt. Probabiliteti që të dy të kenë gjetur numër të njëjtë stemash është:

$$A) C_8^2 \cdot \left(\frac{1}{2}\right)^8$$

$$B) C_{16}^2 \cdot \left(\frac{1}{2}\right)^8$$

$$C) C_{16}^8 \cdot \left(\frac{1}{2}\right)^{16}$$

$$D) C_{16}^8 \cdot \left(\frac{1}{2}\right)^2$$

PS)C

Pyetja 116 V)3

Një ndryshore rasti X ka densitet si në tabelë.

X	0	1	2	4
P(X=x)	1/3	1/3	1/6	1/6

Mënjanimi mesatar katror i numrit X është:

$$A) \frac{17}{3}$$

$$B) \frac{\sqrt{17}}{9}$$

$$C) \frac{\sqrt{17}}{3}$$

$$D) \frac{3}{4}$$

PS)C

Pyetja 117 V)3

Kompania vadafon është e shqetësuar rreth largimit të abonentëve të saj drejt rrjeteve të tjerë konkures. Në vitet e fundit, një studiues ka vënë re se për çdo abonent të zgjedhur rastësisht nga kjo kompani, probabiliteti që ky abonent të jetë përsëri edhe vitin tjetër është 0.5. Zgjedhim 4

abonentë rastësisht. Probabiliteti që vetëm dy prej tyre do të jenë përsëri abonentë vitin e ardhshëm është:

- A) 0.375
- B) 0.275
- C) 0.175
- D) 0.5

PS)A

Pyetja 118 V)3

Është vëzhguar një ATM në rrugën e Kavajës në lidhje me numrin e përdorimit të ATM dhe sasinë e të hollave të tërhequr gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit. Të dhënat janë si më poshtë:

Numri	9	8	15	3	10
Sasia	1000-1500	1500-2000	2000-2500	2500-3000	3000-3500

Moda në lidhje me sasinë e tërhequr është:

- A) 2434
- B) 2334
- C) 2224
- D) 2124

PS)A

Pyetja 119 V)3

Në ceremoninë e hapjes së një dyqani, çdo blerës kishte një shanc për të fituar duke tërhequr një nga biletat e vendosura në një kuti. Në kuti ka 100 bileta. 20 prej tyre shkuajnë "Fituat" dhe të tjerat "Provoni përsëri". Duke supozuar që bileta e tërhequr NUK kthehet përsëri në kuti, atëherë probabiliteti që të dy blerësit të fitojnë është:

- E) ≈ 0.2
- F) ≈ 0.3
- G) ≈ 0.4
- H) ≈ 0.04

PS)D

Pyetja 120 V)3

Në ceremoninë e hapjes së një dyqani, çdo blerës kishte një shanc për të fituar duke tërhequr një biletë nga 100 biletat e vendosura në një kuti. 20 prej tyre shkuajnë "Fituat" dhe të tjerat "Provoni përsëri". Duke supozuar që bileta e tërhequr NUK kthehet përsëri në kuti, atëherë probabiliteti që dy blerës të humbasin është:

- A) ≈ 0.44
- B) ≈ 0.54
- C) ≈ 0.64
- D) ≈ 1.4

PS)C

Pyetja 121 V)3

Në ceremoninë e hapjes së një dyqani, çdo blerës kishte një shanc për të fituar duke tërhequr një biletë nga 100 biletat e vendosura në një kuti. 20 prej tyre shkuajnë “Fituat” dhe të tjerat “Provoni përsëri”. Duke supozuar që bileta e tërhequr NUK kthehet përsëri në kuti, atëherë probabiliteti që në dy blerës i pari të fitojnë dhe i dyti të humbas, është:

- A) ≈ 0.1
- B) ≈ 0.16
- C) ≈ 0.2
- D) ≈ 0.26

PS)B

Pyetja 122 V)3

Në ceremoninë e hapjes së një dyqani, çdo blerës kishte një shanc për të fituar duke tërhequr një biletë nga 100 biletat e vendosura në një kuti. 20 prej tyre shkuajnë “Fituat” dhe të tjerat “Provoni përsëri”. Duke supozuar që bileta e tërhequr NUK kthehet përsëri në kuti, probabiliteti që në dy blerës njëri të fitojnë dhe tjetri të humbas, është:

- A) ≈ 0.1
- B) ≈ 0.16
- C) ≈ 0.2
- D) ≈ 0.32

PS)D

Pyetja 123 V)3

Në ceremoninë e hapjes së një dyqani, çdo blerës kishte një shanc për të fituar duke tërhequr një biletë nga 100 biletat e vendosura në një kuti. 20 prej tyre shkuajnë “Fituat” dhe të tjerat “Provoni përsëri”. Duke supozuar që bileta e tërhequr kthehet përsëri në kuti, probabiliteti që të dy blerësit të fitojnë, është:

- A) ≈ 0.0384
- B) ≈ 0.02
- C) ≈ 0.2
- D) ≈ 0.32

PS)A

Pyetja 124 V)3

Në ceremoninë e hapjes së një dyqani, çdo blerës kishte një shanc për të fituar duke tërhequr një biletë nga 100 biletat e vendosura në një kuti. 20 prej tyre shkuajnë “Fituat” dhe të tjerat “Provoni përsëri”. Duke supozuar që bileta e tërhequr kthehet përsëri në kuti, probabiliteti që të dy blerësit të humbin, është:

- A) ≈ 0.0384
- B) ≈ 0.02
- C) ≈ 0.36
- D) ≈ 0.6384

PS)D

Pyetja 125 V)3

Në ceremoninë e hapjes së një dyqani, çdo blerës kishte një shanc për të fituar duke tërhequr një biletë nga 100 biletat e vendosura në një kuti. 20 prej tyre shkuajnë “Fituat” dhe të tjerat “Provoni përsëri”. Duke supozuar që bileta e tërhequr kthehet përsëri në kuti, probabiliteti që blerësi i parë të fitojnë dhe i dyti të humbas, është:

- A) ≈ 0.03
- B) ≈ 0.02
- C) ≈ 0.2
- D) ≈ 0.16

PS)D